

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE PER AKTIVITETIN



SUBJEKTI : «EUROTECH CEMENT» SH.P.K.

Klasifikimi i projektit: Në bazë të Ligjit nr.52/2020 te date 30.04.2020 per disa ndryshime te ligjit nr.10440 datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", ky aktivitet perfshihet ne Shtojca I, Industria Minerare, pika ID 3.1.d Magazinimi, ngarkimi ose shkarkimi ne mase te madhe i çimentos ose i klinkerit te çimentos perpara transportimit te tyre ne mase te madhe.

ADMINISTRATOR I SUBJEKTIT: MIHAIL KIRILOV LAZAROV

Hartoi materialin Studio Mjedisore « D.E.A. PROJEKT » Sh.p.k.

VENDODHJA: Durres, Durres, Durres, UNAZES L.14, SHKOZET.

PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE

- 1. HYRJE**
- 2. QELLIMI I PROJEKTIT TE PROPOZUAR**
- 3. INFORMACION MBI QENDRAT E BANUARA NE ZONEN KU PROPOZOHET PROJEKTI**
- 4. SKICA DHE PLANIMETRITE E OBJEKTEVE TE PROJEKTT DHE STRUKTURAVE TE PROJEKTIT**
- 5. PERSHKRIMI I PROCEVE TEKNOLOGJIKE,PERFHIRE KAPACITETET PERPUNUESE.**
- 6. INFORMACION PER INFRASTRUKTUREN E NEVOJSHME PER LIDHJEN ME RRJETIN ELEKTRIK, FURNIZIMIN ME UJE,SHKARKIMET E UJRAVE TE NDOTURA DHE MBETJET, SI DHE INFORMACION PER RRUGET EGZISTUESE APO NEVOJEN PER HAPJE TE RRUGEVE TE REJA.**
- 7. INFORMACION PER LIDHJET E MUNDESHME TE PROJEKTIT ME PROJEKTET E TJERA EKZISTUESE PERRETH ZONES SE PROJEKTIT**
- 8. INFORMACION PER ALTERNATIVAT E MARRA NE KOSIDERATE PER SA I TAKON PERZGJEDHJES SE VENDODHJES SE PROJEKTIT DHE TEKNOLOGJISE QE DO TE PERDORET.**
- 9. TË DHËNAT PËR PËRDORIMIN E LËNDËVE TË PARA GJATË FUNKSIONIMIT, PËRFSHIRË SASITË E UJIT TË NEVOJSHËM, TË ENERGJISË, LËNDËVE DJEGËSE DHE MËNYRËN E SIGURIMIT TË TYRE.**
- 10. INFORMACION MBI SHKARKIMET NE MJEDIS NGA AKTIVITETI**
- 11. PROGRAMI I PËRMIRËSIMIT TË PROCESIT TË PUNËS DHE MASAT ZBUTESE**
- 12. PROGRAMI MONITORIMIT**
- 13. INFORMACIONIN PËR LEJET, AUTORIZIMET DHE LIÇENSAT E NEVOJSHME PËR PROJEKTIN, NË PËRPUTHJE ME PËRCAKTIMET E BËRA NË LEGJISLACIONIN NË FUQI, SI DHE INSTITUCIONET KOMPETENTE PËR LEJIMIN / AUTORIZIMIN/ LIÇENSIMIN E PROJEKTIT.**

1. HYRJE

Mjedisi është burimi i gjithçkaje për të cilën njerezit kanë nevojë për të jetuar dhe për të zhvilluar. Sa më i degraduar të jetë mjedisi aq më keq ndikon në shëndetin e njeriut dhe zhvillimin ekonomik-social, prandaj duhet një menaxhim sa më mirë i mjedisit.

Vendi ynë është anetare i një numri konventash ndërkombëtare, si rrjedhojë është i detyruar të zbatojë një sistem sa më efektiv në fushat ekonomik-social-mjedisor, për rregullimin e territorit sidomos në funksion të zgjidhjes së problemeve të ndryshme mjedisore.

Raporti për më tepër do të sigurojë një plan për lehtësim dhe një program monitorimi të cilat mund të zbatohen gjatë periudhës së zhvillimit të projektit.

Ky Raport do të paraqesë nga njëra anë rëndësinë e zbatimit të projektit **piken ID 3.1.d "Magazinimi, ngarkimi ose shkarkimi në mase të mëdha të çimentos ose i klinkerit të çimentos përpara transportimit të tyre në mase të mëdha"** përshkrimin e këtij projekti dhe nga ana tjetër ndikimet negative kryesore në mjedis, masat zbutëse për të minimizuar sa më shumë të jetë e mundur këto ndikime negative, duke llogaritur se si qëndron ekuilibri ndërmjet tyre për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm.

Të paraqesë realizimin e këtij projekti dhe zhvillimin ekonomik që përfitohet prej zbatimit të tij, por gjithmonë duke mbrojtur mjedisin, duke patur parasysh parimin "e zhvillimit të qëndrueshëm". Ky dokument prezanton gjithashtu dhe palët që marrin pjesë, përfitojnë apo preken nga zbatimi i tij. Kjo edhe për vetë faktin se kjo zonë është një zonë mjaft e rëndësishme, jo vetëm për pozicionin gjeografik që ka, por edhe për vlerat dhe resortet që mban.

Në brendësi të kësaj zone vëhet re një sistem rrugor i mirefilltë dhe një pjesë e kësaj hapësire është sipërfaqe e gjelber. Qarkullimi, hyrjet e daljet në aktivitet bëhen nëpërmjet rrugës që kalon pranë projektit. Në këtë zonë kemi shumë aktivitete të ndryshme për arsye pozicioni si dhe lehtësisë së komunikacionit.

Godina në të cilën ndodhet aktiviteti, është pronë private e Shoqërisë "EUROTECH CEMENT" Sh.p.k.

Ky objekt shtrihet në një terren të rrafshët ndërsa prona është e karakterizuar nga një sipërfaqe uniforme ku efekti i erozionit nuk është i ndjeshëm.

Shoqëria **"EUROTECH CEMENT" Sh.p.k. me administrator z. Mihail Kirilov Lazarov** është një subjekt i cili prej vitësh zhvillonë aktivitetin e tij ekonomik të **Magazinimit dhe të tregimit të çimentos në mase të mëdha** në përputhje me legjislacionin në fuqi në Shqipëri.

Vendosja e këtij aktiviteti në këtë zonë është e përshtatshme për zhvillimin e këtij aktiviteti pasi zona ka pranë rrugë Nationale për qarkullimin e mjeteve. Gjithashtu pozicionim buze rrugës kryesore si edhe krijimi rrugëve hyrëse dhe daljeve për në aktivitet krijojnë lehtësira për automjete që futen në aktivitet.

2. QELLIMI I PROJEKTIT TE PROPOZUAR

2.1 Pershkrimi i projektit

Qëllimi i Shoqërisë ka qenë dhe mbetet përmbushja e kërkesave për çimento me cilësi të mirë dhe për këtë kompani ndjek dhe zbaton me rigorozitet menaxhimin e cilësisë në të gjitha hallkat e aktivitetit.

Aktiviteti ka për qëllim: Magazinimin dhe shkarkimin e çimentos në mase të mëdha.

Subjekti " **EUROTECH CEMENT**" Sh.p.k.

e ushtron këto aktivitete prej vitesh dhe është pajisur me të gjithë dokumentacionin përkatës për ushtrimin e këtij aktiviteti. Aktualisht Subjekti për ushtrimin e këtij aktiviteti disponon Leje Mjedisore të Tipit C.

Referuar Shtojcës 1 të ligjit 52/2020 datë

30.04.2020 "PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 448, DATË 14.7.2011, "PËR LEJET E MJEDISIT", TË NDRYSHUAR" aktiviteti i ID 3.1.d Magazinimi, ngarkimi ose shkarkimi në mase të mëdha të çimentos ose i klinkerit të çimentos përpara transportimit të tyre në mase të mëdha.

Për këtë arsye Subjekti " **EUROTECH CEMENT**" Sh.p.k. po ndjek procedurat për të pajisur me Leje Mjedisore të Tipit B për vazhdimin e ushtrimit të aktivitetit të **Magazinimi, ngarkimi ose shkarkimi në mase të mëdha të çimentos ose i klinkerit të çimentos përpara transportimit të tyre në mase të mëdha.**

2.2 Të dhëna teknike të Aktivitetit

Shoqëria " **EUROTECH CEMENT**" Sh.p.k. me administrator z. **Mihail Kirilov Lazarov**, është i regjistruar në QKR me datë 18.11.1997, dhe është pajisur me çertifikatën e regjistrimit si person juridik, me numër **NIPT J 72318015 F**, si dhe ka dokumentacionin e kontratave që ka lidhur për furnizimin me ujë dhe energji elektrike. Këtu midis veprimtarive të tjera ka dhe **Magazinimi, ngarkimi ose shkarkimi në mase të mëdha të çimentos ose i klinkerit të çimentos përpara transportimit të tyre në mase të mëdha.**

Pranë aktivitetit kalon **Rruga Unaza Plepa - Shkozë**. Në këtë zonë nuk ka patur dhe tani as nuk ka asnjë bimë të lartë (dru pyjorë ose pemë frutore).

Aktiviteti është i pajisur me të gjithë aksesoret e nevojshme për këtë aktivitet duke plotësuar kërkesat e mbrojtjes së mjedisit.

Aktiviteti është i mbyllur nga pjesa mbrapa, me hyrje dalje.

Ne zonen ku do te zhvillohet ky aktivitet ka shtepi banimi, shkolla, dhe aktivitete te tjera social kulturore,por qe nuk mund te demtohen nga zhvillimi i ketij aktivitetit nga subjekti.

Objekti ku zhvillohet aktiviteti eshte i sheshte,ne kuoten e rruges.

E tere hapësira ku zhvillohet aktiviteti eshte sistemuar, asfaltuar duke bere te mundur realizimin e nje imazhi pamor mjedisor me cilesor, dhe ka ndikuar ne permirsimin e ndotjes mjedisore dhe permirsimin e pamjes vizuale.

Teritori i aktivitetit eshte e shtruar me asfalt dhe mbahet paster.

Produktet qe tregtohen.

- Çimento rifuxho
- Çimento me thase

Subjekti, për vazhdimin e ushtrimit te aktivitetit të tij do të pajiset me të gjitha miratimet përkatëse të lejeve të nevojshme për funksionimin e tij, **Referuar Shtojces 1 te ligjit 52/2020 date**

30.04.2020 "PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 448, DATË 14.7.2011, "PËR LEJET E MJEDISIT", TË NDRYSHUAR" aktiviteti i ID 3.1.d Magazinimi,ngarkimi ose shkarkimi ne mase te madhe i çimentos ose i klinkerit te çimentos perpara transportimit te tyre ne mase te madhe.

2.3 Vendodhja e aktivitetit

Subjekti "**EUROTECH CEMENT**" Sh.p.k. me administrator z. **Mihail Kirilov Lazarov** ushtron aktivitetin ne Adresen: **Durres,Durres,Durres,UNAZES L.14,SHKOZET.**

Godina ne te cilen ndodhet aktiviteti, eshte prone private e Shoqerise "EUROTECH CEMENT" Sh.p.k.

Ky objekt shtrihet ne nje terren te rrafshet ndersa prona eshte e karakterizuar nga nje siperfaqe uniforme ku efekti i erozionit nuk eshte i ndjeshem.

Ndertesa ku zhvillohet aktiviteti ka nje **siperfaqe totale te prones 7174.86 m2**, e regjistruar ne Z.V.R.P. ne zonen kadastrale **Nr. 8516**,me Nr.Pasurie **17/ 218** ne regjistrin hipotekor me Date **28.02.2019.**

Ne brendesi te kesaj zone vihet re nje sistem rrugor i mirefillte dhe nje pjese e kesaj hapësire eshte siperfaqe e gjelber.

Ne kete zone kemi shume aktivite te ndryshme per aresye pozicioni si dhe lehtesise se komunikacionit.

E tere hapësira ku zhvillohet aktiviteti është sistemuar, asfaltuar duke bërë të mundur realizimin e një imazhi pamor mjedisor me cilësor, dhe ka ndikuar në përmirsimin e ndotjes mjedisore dhe përmirsimin e pamjes vizuale.

Kjo zonë nuk është habitat për specie të rëndësishme të florisë dhe faunës.

Gjithashtu pozicionimi i aktivitetit ekzistues në **Rrugen Unazës Plepa - Shkozë** lehtësira në aksesimin e tij si për **magazinin dhe tregtimin e çimentos** por edhe për automjetet e zjarrfikses në rast të aksidenteve të mundshme si rënia e zjarrit apo ambulancave në rastet e aksidenteve me pasoje në shëndetin e punonjësve.

Zona e përzgjedhur për ushtrimin e këtij aktiviteti është e përshtatshme për këtë lloj aktiviteti duke pasur parasysh përparësitë si:

- Furnizimi me ujë;
- Furnizimi me energji elektrike
- Lehtësi në aksesim nga automjetet (Autobotet e çimentos, zjarrfikset dhe ambulancat)
-

Kondicionet urbane.

Objekti i ndërtuar është në formë "katerkëndeshi"

Sipërfaqja totale e sheshit ku zhvillohet aktiviteti 7174 m²



Pamje e vendosjes së aktivitetit

Kordinatat e objektit ku zhvillohet aktiviteti		
Pikat	X	Y
1	4373360.19	4577733.60
2	4373454.52	4577796.86
3	4373425.08	4577693.09
4	4373493.11	4577742.48

3. INFORMACION MBI QENDRAT E BANUARA NE ZONEN KU PROPOZOHET PROJEKTI

Qarku i Durrësit zë një sipërfaqe prej 76 000 ha dhe shtihet në Ultësirën perëndimore të Shqipërisë Qëndrore.

Qarku përfshin dy rrethe, Durrës dhe Krujë.

Qarku i Durresit ka 351,899 banore dhe 90,939 familje me 495 banore per km2.

Rreth 75 % e popullsisë është përqendruar në rrethin e Durresit. Ndryshimet demografike janë me të dukshme në rrethin e Durresit dhe veçanërisht në qytetin e Durresit, Njesite Administrative Sukth, Rrashbull ,Xhafzotaj e Katundi i Ri.

Aktualisht Qarku i Durrësit me ndarjen e re administrative territoriale është ndarë në 3 Njësi të Qeverisjes Qendrore dhe konkretisht Bashkia Durrës, Shijak dhe Krujë, të cilat kanë përfshirë nën administrimin e tyre komunat dhe fshatat që i karakterizojnë.

Projekti ndodhet në perëndim të Shqipërisë dhe përben një urë lidhëse të veriut me jugun e Shqipërisë si dhe të lindjes me perëndimin.

Pranë projektit kalon **Rruga Unazes Plepa - Shkozet.**

Kjo zonë është pjesë e Bashkisë Durres.

4. SKICA DHE PLANIMETRIT E OBJEKTEVE TE PROJEKTT DHE STRUKTURAVE TE PROJEKTT



Pamje e skemes se terminalit e e afishuar ne hyrje te terminalit.




Figura. Procesi i prodhimit te Çimentos

5. PERSHKRIMI I PROCEVE TEKNOLOGJIKE, PERFHIRE KAPACITETET PERPUNUESE.

Shoqeria "EUROTECH CEMENT" Sh.p.k. eshte pjese e kompanive Italiane "ITALCEMENT GROUP" e cila ze vendin e peste ne bote persa i perket prodhimit te çimentos.kjo Shoqeri ofron per tregun vendas lloje te ndryshme te çimentos sipas kerkesave te konsumatorit.

Vendodhja e objektit favorizohet nga nje infrastrukture e gatshme dhe lidhet me rrugen automobilistike .

Gjithe njesia magazinim eshte e vendosur ne nje hapësire te mjaftueshme per nje proces optimal. Vendosja e gjithe paisjeve te nevojshme eshte zgjidhur ne menyre racionale, funksionale dhe shume praktike, si per realizimin e prodhimit ashtu dhe per personelin punonjes.

Skema Teknologjike

Projekti duke perfshire makinerite dhe proceset e punes qe kryhen ne kete aktivitet jane bashkohore dhe ploteson standartet mjedisore sipas Komunitetit Europian.

Shfrytezimi i ketij objekti eshte menduar nga investitori te behet per Magazinimin dhe shkarkimin e çimentos ne mase te madhe.

Ne funksion eshte dhe nje ambient i vecuar per zyra, ambiente per puntoret per ti perdorur per dhoma zhveshje, duashë, tualete etj.

AMBJENTI PERBEHET

- Magazina
 - Silloset 3 cope
 - Vend roje
 - Zyra
 - Ambientet higjenike
 - Parkingu
 - Ambientet e ngrenies
 - Ambientet e Zhveshjes
- Lenda e pare qe depozitohet dhe tregtohet eshte çimento e cila vjen rifuxho dhe depozitohet ne sillose.
- Ne teritorin e Shoqerise jane vendosur 3 sillose ku shkarkohet çimento qe vjen me vapor dhe nepermjet autoboteve sillet dhe shkarkohet ne keto sillose. Silloset qe nga koha e montimit fillestar dhe deri me tani jane ne gjendje teknike te mire dhe jane mirembajtur

ne vijimesi sipas nje programi te percaktuar dhe te rregullt. Ne fundin e silloseve jane grykat e shkarkimit nga ku merret cimentoja rifuxho nga mjetet te cilet e blejne ate per qellime perdorimi kryesisht per prodhimi betoni.

Silloset ngarkohen me ane te tuabave te ngarkimit. Cimentoja qe sillet nga vaporet me autobote te Shoqerise ngarkohet ne sillose me ane te tubave te ngarkimit. Nje bot me cemento mund te ngarkoj 30 t cemento per 35-40 minuta. Silloset ngarkohen ne kete menyre deri ne kapacitetin e tyre normal. Furnizimi eshte i programuar dhe sigurohet qe ne sillose te kete sasi te mjaftueshme per te furnizuar klientet bazuar ne kerkesat e bera nga ata paraprakisht. Automjetet e klienteve vijne sipas nevojave te tyre dhe ngarkohen nga silloset. Zbrazja e silloseve behet ne menyre te alternaur ndermjet tre silloseve. Nga sillosi i pare mund te ngarkohet nje kamjon 30 t per 26 minuta. Ndersa nga sillosi i dyte nje kamion 30 t ngarkohet per 20 minuta. Nen silloset ndodhet peshorja per te kryer matjen e ngarkesave te kryera nga klientet. Sistemi i grukave mbahet ne gjendje te mire.

Per te shmegur pluhurin nga procesi i ngarkim shkarim te cimontos ne silloje jane instalaur filtra mense te cilet kapin pluhurin e cimontos qe mund te clirohet gjate punes ne sillose.

- Transporti i çimentos nga vapori ne ambientet e silloseve behet me autobotet e Shoqerise. Keta kamjone jane te destinuar qe ne prodhimin e tyre per transporte te tilla materialesh te hapura dhe ndikimi i ndotjes se tyre ne mjedis nga transporti qe kryejne eshte pothuajse zero. Makinerit tipike per transportin e cimontos jane bote 30 ton te cilat lidhen me makina koke qe disponon subjekti.

- Shkarkimi i çimentos nga autobotet ne sillos behet nepermjet pompave dhe shnekeve. Shneket ne pjesen fundore te tyre jane te paisura me nje paisje te veçante ne forme fizarmonike e cila uthitet me gryken e ngarkimit te autobotit dhe quhet Belon.

- Ngarkimi dhe shkarkimi i çimentos behet ne menyre te izoluar me tubacione te pajisura me kapse hermetike te cilat nuk lejojne daljen ne ajer te grimcave te ngurta te çimentos qe te krijohet pluhurine terminal.

Magazina per depozitimin e cimontos se paketuar

Ne magazine depozitohet cemento e paketuar dhe kapaciteti i saj arrine deri ne 1200 ton. Magazina ka hapsira te nevojshme per depozitimin dhe manovirmin me lehtësi te mjeteve ngarkuese pirune apo edhe te afrimit te mjeteve qe ngarkojne cimenton e paketuar. Magazina eshte e mbuluar me llamarine dhe e rrethaur dhe e izolaur nga lageshtia ne menyre qe te mos ndikojne ne cilesine e cimontos se magazinuar. Magazina eshte e ndricuar dhe eshte e shtruar me cemento.

Oficina

Shoqeria ka nje oficine ne pasur ne pajisje dhe makineri. Oficina sherben per te mirmbajtur makinerit dhe pajisjet qe jane te vendosura tek subjekti si dhe te automjeteve qe perdoren per transportin e cimentos. Gjate sezonit te pikut te ndertimeve pranver vjesht oficina dhe pajisjet e makinerit e saja mbahen ne gadishmeri te plote per te sherbyer dhe mirembajtur ne gadishmeri te lart makinerite dhe automjetet e subjektit.

Oficina ofron zakonisht te gjitha sherbimet e nevojshme per makinerit dhe automjetet. Ne gjithë ambjete e subjektit jane te vendosur dhe zbatohet rregullat e sigurimit teknik.

Zyrat.

Zyrat e administrates se Shoqerise jane te vendosura ne nje ndertese nje kateshe. Ndertesa e zyrave ndodhet ne anen e majte te hyrjes ne terminal. Zyrat jane te pajisura dhe te mobiluara dhe me sistem ngrohje e ftohje qendror. Ne ndertese jane te vendosur mbi 6 zyra dhe ambjete te tjera higjene dhe sherbimi per adminsitraten dhe punonjesit.

Ambjentet e higjenes dhe te kujdesit personal.

Shoqeria ka ndertuar ambjete te kujdesit personal (veshja e uniformave) dhe te higjenes per punonjesit dhe adminsitaten e kompanise qe do te punojne ne kompani.

Lulishte.

Kompania do te sistemoj dhe mbjelle me bime e lule siperfaqet ne pjeset e pa shfrytezuar te kompanise.

Rrethimi objektit

Teritori i Shoqerise eshte e rrethuar me mur me lartesi mbi 2.5m. Ne kete menyre evitohet kalimi i personave te cilet nuk jane te autorizuar per te hyre ne ambjentet e Shoqerise.

Shoqeria ruhet me roje private.

Personeli

Shoqeria ka 20 punonjes te cilet jepen en tabelen e meposhteme sipas funksioneve.

Ne tabelen e meposhteme jepen me detaje punonjesit.

Nr	Departamentet	Nr i stafit per cdo departament
1	Adminsitator / magazinier	3
2	Financier	2
3	Mekanik	2
4	Drejtues mjetesh transporti dhe manovrator makinerish dhe pirunash	4
5	Punonjes makinerish	4
6	Teknik	2
7	Inxhinier gjeo-fizik	2
8	Higjene	1
	Total	20

Siperfaqja ne te cilen eshte ndertuar kjo veprimtari ka qene nje siperfaqe toke ne **Lagja 14, Rruga Plepa - Shkozet, Shkozet, Durres**. Kjo ka qene dhe nje nder arsyeset qe investitori ka zgjedhur per te ngritur aktivitetin e tij e te investoje ne kete vend, pasi nuk demton siperfaqen dhe ndodhet buze rruges automobilistike.

Ka dhe ambient te bollshem per parkim te automjeteve e kamioneve.

Territori ku aktualisht do te zhvillohet aktiviteti nuk eshte i perfshire ne menyre te drejtperdrejte ne zone te mbrojtur si rezervat, park kombetar, etj, dhe nuk eshte zone e ruajtur ne perputhje me planet e zhvillimit ekonomik te vendit dhe ne strategjine kombetare te mjedisit.

Nuk eshte zone e perdorur per specie te mbrojtura, te rendesishme te flores dhe faunes, si per kryqezim, pushim, ushqim, dimerim, megrim qe mund te ndikohen nga zhvillimi i ketij aktiviteti.

Nuk eshte zone me rendesi historike apo kulturore dhe nuk ndikon ne rruget e kalimit te publikut apo mjedise te tjera shplodhese, pushuese etj.

Avantash paraqet fakti se objekti (sheshi) eshte ndertuar ne funksion te **Rruges Plepa - Shkozet** ne nje zone ku po behen ndertime te shumta.

Zhvillimi i ketij aktiviteti do te ndikojte deri diku dhe per zbutjen e problemit social te kesaj zone, duke beret e mundur punesim e disa puntoreve. Ngritja dhe shfrytezimi i ketij aktiviteti ka te beje dhe me vendin ku ndodhet pasi nuk ka afer godina e mjedise publike si shkolla, kopshte, cerdhe etj, apo mjedise te komunitetit qe mund te shqetesohen nga zhvillimi i ketij aktiviteti, nga pluhurat dhe gazrat qe

mund të krijohen gjate levizjeve të ndryshme të mjeteve të transportit apo gjate ngarkim shkarkimet e çimentos.

Zhvillimi i aktivitetit, do të shërbejë për zhvillim të mëtejshëm dhe do t'i hap rrugë përmirësimit urban të kësaj zone, e cila ka patur zhvillime urbanistike dinamike kohët e fundit, dhe që vazhdon të tërheqë mjaft interesin e investitoreve privat.

Gjithashtu do të bëjë të mundur realizimin korrekt të projektit, pasi një vlerë të konsiderueshme të investimit do të zërohet mbrojtja, menaxhimi dhe zhvillimi i qendrueshëm i mjedisit përreth. Përveç interesit ekonomik të investitorit që do të investojë, projekti i propozuar ka për qëllim pasurimin estetik të zonës ku pjesën më të madhe të sipërfaqes së lirë të projektit në studim do të zënë mjediset e rrethuara e gjeberuara gjithmone pa prishur imazhin dekorues të kësaj zone.

Në lidhje me ushtrimin e aktivitetit në baze të kërkesës ofertave, është parashikuar që për transportimin të përdoren makina ngarkuese, kamion vetshkarkues, etj.

Më qëllim mos ndërprerjen e trafikut dhe sigurimin e një kalueshmërie normale, pa sjelle rreziqe në qarkullim do të përdoret **Rruga Plepa - Shkozë** duke ruajtur funksionin e rrugës që është shtruar me shtresë asfalti.

Pasi futesh në objekt, anash janë vendosur dhoma e zhveshjes dhe tualetet për puntoret.

Nevojat për ngarkim përcaktohen nga numri i kamioneve të nevojshëm që varen nga distanca e transportimit, disponueshmëria për punë e makinave ngarkuese dhe e kamionve, orët e punës në dispozicion për ditë/turn, etj.

Në aspektin Urbanistik, objekti respekton distancat nga objektet ekzistuese kufiri i pronës, ai i rrugës, etj.

Rreziku për aksidente

Operimi i punës në aktivitet nuk do të sjellë rrezikshmëri për aksidente, duke qenë se nuk do të ketë mbajtje ose përdorim të substancave të rrezikshme. Kujdes i duhet kushtuar mbrojtjes nga tymrat ngritja e pluhurave ose zjarrit, si dhe gjatë operimit të punës në aktivitet.

Sigurimi teknik dhe mbrojtja në punë

Objekti ku zhvillohet aktiviteti është ekzistues dhe është i ndërtuar me planimetri të rregullt, i cili ka respektuar kriteret teknike për funksionimin normal të tij. Ai ka sipërfaqe të mjaftueshme për kryerjen e proceseve të lëvizjes së lirë të punonjësve, disponon hapësira të mjaftueshme për aktivitetin, etj. Ambienti është i pajisur dhe me tualet të cilët janë në gjendje dhe funksionim të mirë.

Impianti i MKZ

Është një sistem që shërbenë për mbrojtjen e objektit në rast rënie zjarri. Përbëhet nga hidrantet e shkumes. Ky instalim ka rol shumë të rëndësishëm, që ka të bëjë me mbrojtjen e objektit nga zjarret e mundshme dhe gjithashtu në veçanti, atë të mbrojtjes së njerëzve, zonës përreth dhe të mjedisit.

Sistemi i ujerave

Ne projekt është parashikuar një sistem i plote kanalizimesh e drenazhimesh, ku orientohen ujerat sipërfaqesor me derdhje të caktuar për në kanal kryesor.

Furnizimi me ujë

Furnizimi me ujë do të shërbejë për nevojat e aktivitetit dhe të mbrojtjes nga zjarri si dhe për nevoja sanitare. Është planifikuar sistemi i ujit të pijshëm i veçuar nga rrjeti i hidrantit. Pas analizës laboratorike të ujit të pusit, i bëhet trajtimi paraprak i tij për nevoja sanitare.

Lidhja e objektit me tubacionin kryesor të ujesjellesit është bërë me marrveshje me Ndermarrjen e Ujesjelles Kanalizime.

Në baze të projektit diametri i tubacionit hyres është 2.5" Tubacioni është prej plastike.

Furnizimi me energji elektrike

Si burim kryesor i energjisë elektrike shërben stacioni i transformatorit TS-33 10 (20)/0, 4kV, me dy transformatore nga 1000 kV. Furnizimi do të jetë sipas kërkesës në marrveshje me kompaninë e furnizimit me energji elektrike. Ky plan i përgjithshëm ka parashikuar që furnizimi të jetë nga SN bllok nga TS-(10MVA) me dy SN kabulla (sistem i hyrje/daljes).

Si burim rezerve i energjisë (në rastin e ndërprerjes nga rrjeti primar) është parashikuar përdorimi i një gjeneratori me naftë me kapacitet 630KVA (ivendosur afër ndërtesës së transformatorit). Kalimi në furnizim me gjenerator është automatik. Si burim i veçantë i energjisë është parashikuar dhe UPS, e cila është e dedikuar për furnizim të sigurt të pajisjeve të kontrollit dhe të sinjalizimit të punës së pajisjeve, i cili ndodhet në ndërtesën kryesore administrative.

Ndricimi

Ndricimi i brendshëm

Ndricimi përkrah për automjete zgjidhet në kompleks me objektet e planimetrise në kuotën +0,00. Gjithashtu në përcaktimin e fuqisë së ndricimit të nevojshëm janë patur parasysh normat dhe kushtet teknike për objekte të tilla.

Ndricimi i jashtëm

Duke patur parasysh regjimin e punës së objektit në teresi është parashikuar ndricimi i vendeve ku

kryhen manipulime te ngarkim-shkarkimit te mallrave nga mjetet transportuese. Gjithashtu per qellime te ruajtjes si dhe te manovrimeve te mjeteve levizese brenda territorit te kompleksit te ndertimeve, eshte parashikuar ndricimi nga jashte ne teresi.

Nderlidhja

Nderlidhja e pikes sherbimit ne teresi (magazina dhe zyra), realizohet me telefon fiks nepermjet linjes qe kalon aty prane. Gjithashtu nderlidhja realizohet edhe me telefon celular.

Organizimi menaxherial i punes

Per drejtimin dhe operimin e pikes se shitjes sherbimit per (klinkerit ose cimentos), eshte menduar te sherbeje nje punonjes. Kjo eshte percaktuar duke konsideruar regjimin e punes si dhe karakterin e saj.

6. INFORMACION PER INFRASTRUKTUREN E NEVOJSHME PER LIDHJEN ME RRJETIN ELEKTRIK,FURNIZIMIN ME UJE,SHKARKIMET E UJRAVE TE NDOTURA DHE MBETJET,SI DHE INFORMACION PER RRUGET EGZISTUESE APO NEVOJEN PER HAPJE TE RRUGEVE TE REJA.

Aktiviteti në vlerësim ndodhet në **Lagja 14,Shkozet,Durres.**

Sheshi ku do zhvillohet aktiviteti në fjale ndodhet ne brendesi te prones dhe nuk cenon pronat e tjera perreth.

Duke qene se instalimi ne fjale i perket aktivitetit te magazinimit te çimentos.

Lenda e pare qe depozitohet dhe tregtohet eshte çimento e cila vjen rifuxho dhe depozitohet ne sillose.Ne teritorin e shoqerise jane vendosur 3 sillose ku shkarkohet çimento qe vjen me vapor dhe nepermjet autoboteve sillet dhe shkarkohet ne keto sillose.

Lende te para	Lende ndihmese
Çimento rifuxho	Uji
Çimento me thase	Energji elektrike
	Lende djegese per gjeneratorin

Infrastruktuar ne zonen e ushtrimit te aktivitetit eshte e gatshme ku perfshihen, infrastruktura rrugore, rrjeti i furnizimit me uje te pijshem, rrjeti i furnizimit me energji elektrike, rrjeti i shperndarjes se internetit si edhe rrjeti i kanalizimeve te ujrave te zeza.

Furnizimi me ujë

Furnizimi me ujë do të shërbejë për nevojat e aktivitetit dhe të mbrojtjes nga zjarri si dhe për nevoja sanitare. Eshte planifikuar sistemi i ujit të pijshëm i veçuar nga rrjeti i hidrantit.

Pas analizës laboratorike të ujit të pusit, i bëhet trajtimi paraprak i tij për nevoja sanitare.

Lidhja e objektit me tubacionin kryesor të ujesjellesit eshte bere me marrveshje me Ndermarrjen e Ujsjelles Kanalizime.

Ne baze te projektit diametri i tubacionit hyres eshte 2.5" Tubacioni eshte prej plastike.

Për të gjithë zonën e studiuar, objekti do të plotësojë nevojat e tij për ujë higjeno-sanitar nëpërmjet shfrytëzimit të rrjetit ekzistues dhe përta i përket sistemit të shkarkimit të ujrave eshte lidhur me kanalizimet ekzistuese në zonë.

Furnizimi me energji elektrike

Si burim kryesor i energjise elektrike sherben stacioni i transformatorit TS-33 10 (20)/0, 4kV, me dy transformatore nga 1000 kV. Furnizimi do te jete sipas kerkeses ne marreveshje me kompanine e furnizimit me energji elektrike. Ky plan i pergjithshem ka parashikuar qe furnizimi te jete nga SN bllok nga TS-(10MVA) me dy SN kabulla (sistem i hyrje/daljes).

Si burim rezerve i energjise (ne rastin e nderprerjes nga rrjeti primar) eshte parashikuar perdorimi i nje gjeneratori me naftë me kapacitet 630KVA (ivendosur afer nderteses se transformatorit). Kalimi ne furnizim me gjenerator eshte automatik. Si burim i veçante i energjise eshte parashikuar dhe UPS, e cila eshte e dedikuar per furnizim te sigurt te pajisjeve te kontrollit dhe te sinjalizimit te punes se pajisjeve, i cili ndodhet ne ndertesën kryesore administrative.

Lendet djegese

Subjekti si lende djegese perdor naften per te vene ne pune gjeneratorin qe e merr ne piken me te afert te karburantit. Gjeneratori perdoret ne raste te rralle vetem ne momentin qe ka nderpreje te energjise elektrike.

Sistemi Rrugor Vendosja e këtij aktiviteti në këtë zonë është e përshtatshme për zhvillimin e këtij aktiviteti pasi zona ka Rruge Nacionale prane. Gjithashtu pozicionimi buze rruges kryesore si edhe krijimi i rrugeve hyrese dhe dalese per ne aktivitet krojin lehtesira per automjete ne aktivitet. Funkionimi këtij Projekti nuk do të ndikojë në dëmtimin ose devijimin e infrastrukturës ekzistuese. Në pronë sigurohet aksesi nëpërmjet rrugës egzistuese e cila është e shtruar.

Largimi i ujrave të zeza dhe i ujrave atmosferike bëhet përmes kanaleve deri në puseta për mbledhjen e ujrave të zeza e cila llogaritet sipas kapacitetit. Puseta vendoset në pjesën ku me se paku i pengon aktivitetin.

Energjia Elektrike që nevojitet do të merret nga Rrjeti kryesor elektrik nëpërmjet një matësi në pikën më të afërt të mundshme, e cila do të caktohet nga filiali i OSHEE që e ka në përdorim linjën elektrike dhe do të jepet në përdorim me anë të kontratës përkatëse.

Ka rrugë të mira në zonë dhe në brendësi të Projektit, nuk do të hapen rrugë të reja për këto qëllime por do të shfrytëzohen ato ekzistuese.

Nuk do të ndërtohet ujësjellës i ri.

Nuk do të ndërtohet rrjet elektrik i ri.

Mbetjet e ngurta do të menaxhohen në bashkëpunim me **Bashkinë Durrës** dhe do të përcaktohet vendi i depozitimit të tyre nga Bashkia.

Pastrimi i mbetjeve urbane do të kryhet nëpërmjet vendosjes së koshave të mjaftueshëm.

Mbetjet e prodhuara

Mbetjet e gjeneruara do të grumbullohen në pika grumbullimi ose vend depozitime të caktuara nga Njësia e Qeverisjes Vendore (NJ.Q.V).

Këto mbetje duhet të menaxhohen në bashkëpunim me Njësine e Qeverisjes Vendore dhe firmën pastruese të territorit.

Grumbullimi i mbetjeve duhet të jetë i diferencuar që në vendburim.

Mbetje janë mbetjet e ngurta urbane si plastike, qelqi, materiale letre, metale, mbetje organike.

Grumbullimi i mbetjeve duhet të jetë i diferencuar që në vendburim. Mbetjet e pariciklueshme duhet të dërgohen në një landfill të miratuar.

Depozitimi i mbetjeve do të bëhet në përputhje me **"Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" i ndryshuar dhe të shoqërohet me plotësimin e shtojcës 1 të VKM nr.229, datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme" si dhe VKM nr.371, datë 11.06.2014 "Për përcaktimin e rregullave për dorezimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorezimit të mbetjeve të rrezikshme".**

Gjendja ekzistuese e rrugëve

Ekzistojnë rrugë akses të përgjatë kufijve në lindje dhe në jug të projektit. Rrugët kryesore përgjatë kufirit perëndimor dhe gjatë qendrës së zonës janë të ndërtuara, ndërkohë që zona do ketë së shpejti një plan të studiuar dhe të miratuar të infrastrukturës rrugore.

Nuk është e nevojshme hapja e rrugëve të reja për projektin.

7. INFORMACION PER LIDHJET E MUNDESHME TE PROJEKTIT ME PROJEKTET E TJERA EKZISTUESE PERRETH ZONES SE PROJEKTIT

Projekti i Subjekti "EUROTECH CEMENT" Sh.p.k. me administrator z.Mihail Kirilov Lazarov do të ushtroj aktivitetin në Adresen: **Durres,Durres,Durres, UNAZES L.14,SHKOZET.**

Vendosja e këtij aktiviteti në këtë zonë është e përshtatshme për zhvillimin e këtij aktiviteti pasi zona ka pranë Rrugën Nacionale. Gjithashtu pozicionimi buze rrugës kryesore si edhe krijimi i rrugëve hyrese dhe daljeve për në aktivitet krijin lehtësira për automjete që vijnë në aktivitet. Infrastruktura në zonën e ushtrimit të aktivitetit është e gatshme ku përfshihen, infrastruktura rrugore, rrjeti i furnizimit me ujë të pijshëm, rrjeti i furnizimit me energji elektrike, rrjeti i shpërndarjes së internetit si edhe rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza. Ka rrugë të mira në zonë dhe në brendësi të Projektit, nuk do të hapen rrugë të reja për këto qëllime por do të shfrytëzohen ato ekzistuese. Nuk do të ndërtohet ujësjellës i ri. Nuk do të ndërtohet rrjet elektrik i ri.

7.1 Ndjekja e gjithë kërkesave ligjore për veninë në funksion të aktivitetit duke mbajtur parasysh kufizimet dhe detyrimet kundrejt shtetit dhe paleve të treta.

- Nga ky aktivitet nuk parashikohen të këtu ndikime në ndryshimin e habitateve
- Mbetjet e gjeneruara nga punonjësit do të grumbullohen në kazanet e veçanta. Kazanet do të zbrazen rregullisht dhe mbetjet do të hidhen në vendin e përcaktuar nga Njësia Vendore për mbetjet urbane.
- Do të ndiqen gjithë rregullat e sigurimit teknik në punë si dhe pajisjes së punonjësve me uniformat dhe mjetet e nevojshme të mbrojtjes në punë.
 - Mbetjet urbane të grumbullohen transportohen dhe depozitohen në oraret e caktuara
 - Janë marrë masa për ndriçimin përreth (vendosja e impiantit të ndriçimit).
 - Shoqëria operon në përputhje të plote me normat që janë në fuqi, dhe duke qenë aktiviteti egzistues kryen monitorime të vazhdueshme të tregueseve mjedisore të trysnise në mjedis.
 - Janë marrë masa në projekt për instalimin dhe respektimin e sinjalistikës e trafikut të cilat do të minimizojnë impaktet për aksidente të mundshme.

- Per te minimizuar impaktin ndaj zhurmave dhe vibrimeve, do te limitohen proceset e zhurmshme gjate oreve me te ndjeshme, ndermjet ores 20 e mbremjes deri ne 07⁰⁰ te mengjesit.
- Do te respektohen te gjitha kushtet dhe masat ne Lejen e Mjedisit qe do te vendosen nga AKM-ja dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Nga vleresimet e mesiperme, shkarkimet e prithshme ne mjedis jane te uleta dhe nuk perbejne problem serioz per mjedisin. Megjithe perparsite qe ka ky aktivitet, duhet te tregohet kujdes ne menaxhimin dhe mbajtjen nen kontroll te kushteve teknike per te minimizuar humbjet aksidentale ose shkarkimet.

8. INFORMACION PER ALTERNATIVAT E MARRA NE KOSIDERATE PER SA I TAKON PERZGJEDHJES SE VENDODHJES SE PROJEKTIT DHE TEKNOLOGJISE QE DO TE PERDORET.

Per percaktimin e vend vendosjes se projektit jane bere studime dhe matje paraprake nga vete Shoqeria, kushtet klimatike, dhe tregues te tjere te nevojshem.

Zhvilluesi "**EUROTECH CEMENT**" Sh.p.k. ne rolin edhe te Subjektit qe do bej permiresim te veprimtarise se vet me vendqendrim te veprimtarise ne **Lagja 14,Shkozet,Durres.**

Zgjidhja optimale e projektit te siguron sherbim me teknologji e me sigurim teknik.

Ane pozitive e ketij projekti eshte se, rreth tij ka ambiente banimi, familjare por megjithate projekti do ta zhvilloj aktivitetin duke u mbeshtetur ne legjislacionin e sotem te Republikes se Shqiperise per mbrojtjen e Mjedisit. Perparsi ne kete Projekt do ti jepet mbrojtjes se mjedisit nga ndotja. Per te siguruar nje mjedis te paster e pa problem per personelin e sherbimit si edhe per objekte afer aktivitetit, eshte parashikuar nje sistem kanalizimesh, tubacionesh te cilat ne bashkeveprim do te orientojne ujerat e shiut dhe te aktivitetit.

9. TË DHËNAT PËR PËRDORIMIN E LËNDËVE TË PARA GJATË FUNKSIONIMIT, PËRFSHIRË SASITË E UJIT TË NEVOJSHËM, TË ENERGJISË, LËNDËVE DJEGËSE DHE MËNYRËN E SIGURIMIT TË TYRE.

Gjatë funksionimit të projektit, do të nevojitet uji, energjia elektrike, uje, lende djegese si dhe produkte të konsumit të përditshëm.

Çimento	280.000 ton/vit
Energji	84.000 kwh/vit
Uji	100 m3/vit

Uji që nevojitet për zbatimin e këtij projekti është marrë nga rrjeti kryesor nëpërmjet një matësi në pikën më të afërt të mundshme, e cila është caktuar nga Ndërmarrja e Ujësjellësit që e ka në përdorim linjën e Ujësjellësit. Lidhjet me rrjetin kryesor dhe kostot përkatëse në lidhje me furnizimin me ujë do të paguhet nga Shoqëria.

Furnizimi me energji elektrike

Energjia Elektrike që nevojitet do të merret nga Rrjeti kryesor elektrik nëpërmjet një matësi në pikën më të afërt të mundshme, e cila do të caktohet nga filiali i OSHEE që e ka në përdorim linjën elektrike dhe do të jepet në përdorim me anë të kontratës përkatëse.

Shkarkimet e ujërave do të lidhen me sistemin ekzistues të kanalizimeve të zonës.

Lenda djegese do të sigurohet nga pika e karburantit me e afert me Projektin.

10. INFORMACION MBI NDIKIMET NE MJEDIS TE PROJEKTIT

10.1 Informacion mbi shkarkimet ne mjedis

Shkarkimet në mjedis gjatë fazës së funksionimit të këtij aktiviteti do të jenë minimale. Do të jenë kryesisht pluhurat nga lëvizja e automjetit (autobotit të cimentos) dhe zhurmat teknologjike të këtij të fundit në mjediset e punës. Nga ky aktivitet nuk gjenerohen mbetje të ngurta. Mbetjet e gjeneruara janë vetëm mbetje nga konsumi i përditshëm i puntorëve. Të gjitha mbetje të grumbulluara do të dërgohen në vendin e caktuar nga Pushteti vendor.

10.2 Ndikimet negative

Identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedis

Mjedisi është gjithmonë i prekur nga veprimtaritë e ndryshme që ushtrohen në të, por ndikimi mund të jete i ndryshëm, kjo është e lidhur ngushtë me vetë llojin e veprimtarisë e cila mund të ketë impakt të drejtpërdrejtë, të tërthortë, të rëndësishëm apo mesatar i pranueshëm.

Një nga objektivat e këtij raporti është identifikimi i ndikimeve të mundshme që mund të shkaktohen në mjedis nga ky aktivitet në terësi.

Identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedisin e kësaj zone do të vlerësohen në njërin prej fazave kryesore; faza e operimit, pasi aktiviteti është ekzistues dhe ndikimi në mjedis do të jetë vetëm gjatë ushtrimit të aktivitetit. Nuk marrin në konsideratë fazën pas përfundimit të veprimtarisë pasi ky aktivitet do vazhdojë të jetë i tillë dhe pas shumë kohësh.

Disa prej ndikimeve kryesore që janë vlerësuar si të mundshme janë paraqitur si më poshtë.

Efektet e mundshme nga aktiviteti që ushtrohet do të vlerësohen në mënyrë të përgjithshme në kërkesën për Leje Mjedisi Tipi B. Megjithatë, shumë nga efektet e mundshme mund të identifikohen për arsye të eksperiencës nga nënprojektet e projektet e mëparshme në këtë fushë.

10.3 Impakti në mjedis nga menaxhimi i tij

Në vijim do të paraqesim një përmbledhje të efekteve negative mbi mjedisin të cilat lidhen me aktivitetin e **Magazinimit dhe tregimit të çimentos** gjatë fazës operative së bashku me rekomandimet mbi menaxhimin e tyre.

10.4 Matrica e ndikimeve të mundshme në mjedis nga zbatimi i projektit.

Në tabelat e mëposhtme janë identifikuar ndikimet e mundshme në mjedis të projektit sipas fazave të zbatimit të tij.

Faza operacionale			
Nr.	Receptori Mjediso	Operacioni	Ndikimi i mundshëm
1	Cilësia e ajrit	Emetim gazesh nga automjetet dhe pluhuri për shkak të qarkullimit të tyre. Nga zhvillimi i aktivitetit	Ndikim mesatar në cilësinë e ajrit. Ndikimi mund të shtrihet deri në një zonë rrethuese me rreze 50 m nga kufijtë e pronës. Mund të kontrollohet dhe shmangët me masat e duhura të menaxhimit.
2	Zhurmë	Zhurmë e gjeneruar nga lëvizjet e mjeteve (Autoboteve të çimentos dhe makinerite të ngarkim - shkarkimit, etj.).	Ndikimi do të jetë më i ndjeshëm gjatë ngarkim – shkarkimit të autoboteve
3	Cilësia e ujërave	Rrjedhjet aksidentale të automjeteve në territorin e aktivitetit.	Depertimi i këtyre në shtresat e tokës dhe u përzier me ujrën netokësore. Nënveprimin e agjentëve atmosferikë mund të orientohen drejt burimeve ujore sipërfaqësore duke përkeqësuar cilësinë e tyre. Ndikimi i ulët i cili mund të kontrollohet dhe shmangët me masat e duhura të menaxhimit.
4	Toka	Rrjedhjet aksidentale të automjeteve në territorin e aktivitetit.	Sheshet e qëndrimit të automjeteve dhe të ushtrimit të aktivitetëve tjerë janë të shtruar dhe të pajisura me sisteme drenazhimi, mundësia për depërtim në tokë pothuajse nuk ekziston.

5	Mjedisi socio - ekonomik	Mundësi të mira punësimi. Ofrimi i shërbimeve me cilësi të lartë për qytetarët. Gjenerim të ardhurash nga aktivitetet shtesë.	Ndikimi socio – ekonomik është përgjithësisht pozitiv.
6	Mbetjet	Aktiviteti njerezor i punonjesve Mbetje nga aktiviteti	Ndikim i ulët pasi këto mbetje grumbullohen në koshat që janë vendosur në ambientet e aktivitetit Grumbullimi dhe menaxhimi nga subjekte të licensuar për trajtimin e tyre.
7	Trafiku		Ndikim në rritjen e trafikut të zonës ku ushtrohet aktiviteti.

10.5 Emetimet e zhurmave dhe gazeve të makinave te transportit në mjedis

Sa lidhet me emetimin e zhurmave gjatë procesit te transportit, duhet theksuar se ky ndikim është i minimizuar.

Ndërkohë Udhëzimi nr.8 datë 27.11.2007 "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara", përcakton vlerat e lejuara të zhurmës si në tabelën e mëposhtme. Nivelet kufi të zhurmës në mjedise të caktuara.

Mjedisi	Efekti kritik në shëndet	LAeq (dBA)	(Koha b azë (orë))	LAmaz (dB)
Zona banimi				
Jashtë banese	Bezdi (shqetësim) serioze gjatë ditës dhe mbrëmjes	55	16	-
	Bezdi (shqetësim) i moderuar gjatë ditës dhe mbrëmjes	50	16	-
Në brendësi të banesave	Kuptueshmëri e bisedës dhe (bezdi) shqetësim i moderuar gjatë ditës dhe mbrëmjes	35	16	-
Në brendësi të dhomës së fjetjes	Prishja e gjumit natën	30	8	-
Jashtë dhomës së fjetjes	Prishje e gjumit, dritare e hapur (vlera	45	8	-
Zona me aktivitetet social-ekonomik				
Zona industriale, tregtare, Qarkullimi trafiku (mjedis i jashtëm dhe i brendshëm)	Dëmtim dëgjimi	70	24	110
Mjedisi urban				
Mjedise publike, të jashtme apo të brendshme	Dëmtim dëgjimi	85	1	110

10.6 Rekomandime për zbutjen e ndikimeve

Toka /Përdorimi i Tokës

Kryerja e aktivitetit brënda sipërfaqes së kërkuar për zhvillimin e aktivitetit.

Rrespektimi i kushteve teknike dhe standarteve.

Cilësia e ajrit /Rritje e emetimeve ne ajer nga funksionimi i instalimit dhe djegia e karburantit të automjeteve ngarkim---shkarkimit

Mirëmbajtja e instalimeve dhe mjeteve të transportit sipas kapacitetit mbajtës.

Mjete me kolaudim optimal. Plan veprimi në rast rrjedhjesh.

Përdorimi eficient i mjeteve motorrike.

Përdorim i karburanti cilësor.

Pastrim periodik i sipërfaqes së aktivitetit dhe mjeteve të punës.

Sistemi i drenazhimit

Mirëmbajtja e sistemit të drenazhimit të ujrave të shiut nga pastrimi përgjatë gjithë gjatësisë së sipërfaqes së aktivitetit,

Mbetjet/Shtim i mbetjeve industriale dhe urbane nga aktiviteti human i punonjësve që do të operojnë në aktivitet.

Vendosja e kontenierëve në brendësi dhe jashtë objektit, diferencimi i mbetjeve sipas fraksioneve të gjeneruara dhe transportimi periodik i tyre në vendepozitim më të afërt të caktuar nga njësia vendore.

Zhurmat/Rritje e nivelit të zhurmave nga impianti dhe nga lëvizja e automjeteve

Përdorimi i mjeteve të kolauduara.

Përdorimi i mjeteve mbrojtëse nga punonjësit (kufje për mbrojtjen e aparatit të dëgjimit).

Përdorimi i mjeteve të punës dhe të transportit gjate orareve të përshtatshme.

Trafiku Rrugor/Rritje e fluksit të qarkullimit të automjeteve.

Lëvizshmeria do të studiohet të kryhet në oraret ku shmanget piku i trafikut.

Mjetet e transportit do te levizin brenda normave te lejuara te shpejtesise,referuar Kodit Shqiptar Rrugor.

11. PROGRAMI I PËRMIRËSIMIT TË PROCESIT TË PUNËS DHE MASAT ZBUTESE

Për plotësimin e kërkesave të klientëve, rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar, rritjen e masave të sigurisë gjatë procesit të operimit në ruajtjen/magazinin, tregetim, mbrojtjen nga gazrat, pluhurat, zhurmat, etj, mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe komunitetit të zonës përreth, me qëllim kryesor "Mbrojtjen e Mjedisit", reduktimin e sasisë së emetuar të PM10, CO2, NOx, Sox në atmosfere, përdorimin e energjisë në mënyrë eficiente, duke menduar për gjeneratat e brezave pasardhës, Subjekti "EUROTECH CEMENT" Sh.p.k, ka hartuar "Programin e Përmirësimit të Operimit të Proceseve Teknike të Punës", sipas termave të mëposhtme.

Programi i përmirësimit të operimit mbështetet në këto parime të zbatueshme:

11.1 Masat e nevojshme për zbutjen e ndikimeve

Masat kryesore të propozuara në Planin e Menaxhimit të Mjedisit duhet të adresojnë zgjidhjet më optimale për minimizimin e ndikimeve të identifikuar negative në mjedis.

Këto masa duhet të synojnë:

- Kontrollin dhe mbajtjen e ndikimeve brenda zonës;
- Shmangien e efekteve negative në shëndet dhe mjedis.

Zbatimi me korrektësi i këtyre masave do të bëhet i mundur nga përdorimi i teknikave të mëposhtme:

- Piketimi i saktë i sipërfaqes ku zhvillohet aktiviteti, si dhe kufizimi i veprimtarisë vetëm brenda saj;
- Plan -- organizimi në mënyrë që të mos impaktohen sipërfaqet jashtë ndërhyrjes;
- Hapja e kanaleve të nevojshëm perimetral për kullimin drejtimin e ujrave të shiut, me qëllim shmangien e ndotjes në ujëra;
- Kontrolli i pluhurave nëpërmjet lagies së zonës;
- Kontrolli teknik i automjeteve për të parandaluar rrjedhjet e karburantit dhe çlirimet tej normave të gazeve.

11.2 Menaxhimi i ujrave ne aktivitet

- Ujrat e godinave apo zyrave qe mund te preceptojne nga reshjet apo larjet ne sheshin para tyre, do te kullojne ne kanalet anesore nga ku te grumbulluara, do te vazhdojne te shkarkohen ne pusetat anesore e me tej ne kanal in kryesor qe kalon prane rruges.

- Teritori eshte e shtruar me betoni industrial ne menyre qe mos te kemi mbledhje te ujrave por filtrimin e tyre ne toke.
- Ujrat e ndotura urbane (ujrat e zeza) qe do te shkarkohen nga tualeti (WC) do te shkarkohen direkt ne rrjetin e kanalizimeve ne kolektorin kryesor te ujrave te zeza.

Ujerat pasi dekantohen dhe filtrohen kalojne ne rrjetin e kanalizimeve të ujrave të zonës, pa shkaktuar probleme, ndërsa ujrat e zeza shkarkojnë në kanalizimet e ujrave të zonës

11.3 Mbrojtja e ujrave nentokesore

Aktiviteti nuk ka shkarkime te ujrave te ndotur qe te mund te krijojne probleme per ndotjen e mjedisit ne pergjithesi dhe ne vecanti te ujit, qofte ky nentokesor ose siperfaqesor. Sasia e tyre do te jete minimale, pasi sheshi eshte i shtruar me beton, ka rrjet kanalizimish, per ti orjentuar, trajtuar dhe kapjen dhe vecimin e ndotesve. Aktiviteti nuk eshte nje burim potencial i ndotjes se ujit.

11.4 Menxhimi i mbetje

- Mbetjet jo te rrezikeshme do te vecohen nga komponentet e pastera dhe do te grumbullohen per nje depozitim dhe riciklim te mundshem.
- Mbetjet e rrezikeshme ne te cilat do te bejne pjese ato vajore, Vajra rrjedhese, detergjente etj, do te depozitohen ne nje kontenier te caktuar per grumbullimin e ketyre mbetjeve.
- Vendodhja e aktivitetit eshte ne ane te rruges dhe jo prane ndonje qendre banimi apo aktiviteti social. Gjenerimi i zhurmave eshte brenda normave te lejuara dhe nuk do te kete shqetesim per banoret perreth.
- Kryhet pastrimi periodik i sheshit te aktivitetit.
- Transporti i mbeturinave behet ne oret me trafik te pakesuar.
- Sic eshte theksuar edhe me siper gjenerohen mbetje te vogla nga zhvillimi i aktivitetit.
- Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti jetesor i punetoreve apo ambalazhet do te grumbullohen neper thase te posaçem dhe do te transportohen drejt qendrave me te aferta te banuara per menaxhim nga sektoret perkates te pushtetit lokal.

11.5 Minimizimi i ndotjes së ajrit

- Subjekti gjatë kohës me temperatura të lartë e të ulët mjedisin përreth me ujë dhe pusë që është hapur për këto qëllime përreth një deri dy here në ditë për të reduktuar çlirimet dhe pluhurave nga lëvizja e mjeteve.
- Ndotja e ajrit është në nivele të ulëta, vetëm i pluhurave që krijohen nga mjetet që futen në territorin e **aktivitetit** që vijne për ngarkim – shkarkim .
- Ndotja e ajrit është në nivele të ulëta vetëm nga gazrat që dalin nga skapamentot e makinave gjatë hyrjes dhe daljes në **aktivitet dhe nga ngarkim – shkarkimi i çimentos**.

11.6 Zgjidhja e problemit të zjarrit nga shkarkesat elektrike

- Të gjitha pajisjet e mjetet si dhe, linja teknologjike, etj, për të eliminuar rreziqet e krijimit në të ngarkesave elektrostatike janë të tokezuara.
- Për të gjithë sistemin e linjave qarkulluese nuk do të ketë shtesë ndërrprerëse por bashkim me fllanxha, që të jete eliminuar lidhja elektrike e vazhdueshme me anë të urave.

11.7 Mbrojtja nga Zjarri

Subjekti **"EUROTECH CEMENT" Sh.p.k** për ushtrimin e këtij aktiviteti ka marrë të gjitha masat e dukura në bazë të kushteve të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit (PMKZ) për një funksionim normal dhe pa avari të paisjeve të ndryshme në aktivitet.

Në zbatimin e germës b, të Nenit 34 të Ligjit Nr.8796 datë 05.04.2001 "Për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpetimin", Shoqëria ka marrë masat e nevojshme për mbrojtjen në rast të rrezikut të zjarrit.

Për mbrojtjen nga Zjarri në Subjekt janë marrë masat e mëposhtme:

- Një rezervuar uji 2 m³
- Ka fikse zjarri me shkumë dhe pluhur.
- Ka rregullore të brendshme të PMNZSH-se.
- Personeli është i instruktuar me rregullat e PMNZSH-se.
- Automjeti Zjarrfikës afrohet nga të tre anët e objektit.
- Janë vendosur bombola zjarrfikëse në ambientet e punës.
- Në mënyrë periodike bëhet kontrolli i paisjeve dhe i mjeteve të MNZ si dhe bëhet kualiteti i tyre në mënyrë që të parandalohet rreziqet e mundshme.

- Jane vendosur tabela për mbrojtjen nga zjarri, si dhe për përdorimin e zjarrrshuesve në rast aksidente nga zjarri në pikën e karburantit.
- Për të mbrojtur nga ndonjë zjarri i mundshëm që mund të bëjë janë ruajtur largësitë mbrojtëse ndaj zjarrit duke ruajtur largësinë e godinës dhe objekteve përreth.
- Jane lënë distancat e përcaktuara për rrugë kalim të automjeteve, zjarrefiksive.

Ky subjekt ushtron prej vitesh aktivitetin konform të gjitha ligjeve dhe dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me ushtrimin e këtyre aktiviteteve. Gjate kësaj periudhe ky subjekt ka zbatuar me korrektesë të gjitha dispozitat ligjore, kushtet teknike të punës, duke krijuar edhe një mjedis bashkëkohor për këto lloje aktiviteti.

11.8 Masat për mbrojtjen e mjedisit

Masat për mbrojtjen e mjedisit që janë marrë nga ana e subjektit janë:

- Rregullimi, sistemimi dhe rrethimi i territorit.
- Instalimi i sistemit të ndarjes së ujërave të kanaleve të grumbulluara nga kanalet sipërfaqësore të objektit.
- Jane bërë kanalizimet e brendshme të objektit të lidhura me tubacionin kryesor që shkarkohet në kanal në pranë objektit.
- Ujërat sanitare janë lidhur me rrjetin e kanalizimeve të kësaj zone.
- Në kanalizimin e zonës derdhen vetëm ujërat e shiut.
- Mbetjet e ngurta jo të rrezikshme që do të krijohen do të grumbullohen në stacionin e karburantit dhe periodikisht nga stafi i punës do të perfundojnë në konteneret e zonës e me pas me anë të shërbimit të transportit të mbetjeve nga Bashkia do të shkojnë në landfillin e zonës.
- Projekti përputhet me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë miratuar nga KKT, ku ky objekt është i ndërtuar tashmë dhe me leje ndërtimi të miratuar.

11.9 Masat Parandaluese

- Përzgjedhja dhe trajnimi i personelit për mënyrën e veprimit gjatë proceseve të ndryshme në aktivitet.
- Minimizimi dhe evidentimi i zhurmave të mundshme.
- Zbatim rigoroz i sigurimit teknik gjatë punës dhe ndërprerjes së sajë në rast avarie të mundshme.
- Montimi i të gjithë aparateve sinjalizuese të sigurisë dhe rrjetit elektrik.

- Tokëzimi dhe rrufe pritëse, në të gjithë instalimet për të shmangur aksidente me pasoja në mjedis.
- Mbajtja gjithmone fikur e automjeteve kur nuk është e nevojshme përdorimi i tyre dhe ruajtja e distancës së sigurisë, gjatë operimit të punës nga punonjësit;
- Mbajtja e pajisjeve të nevojshme, nga punonjësit për operimin e punës,
- Lyerja e ambientit të punës (zyra, magazine) dhe pajisjeve me bojë antikorrozive (kundra ndryshkut) çdo dy vite sipas një programi të veçantë, me qëllim mbrojtjen nga korrodimi.
- Pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujrave teknologjike të larjes dhe të shiut, si dhe mirëmbajtja e pemëve.
- Kolaudimi periodik i mjeteve të transportit
- Monitorimi periodik i parametrave mjedisor dhe regjistrimi i të dhënave në regjistrin e shoqërisë.

11.10 Masat Kontrolluese

- Pastrimi i sheshit ku zhvillohet aktiviteti dhe atij të lëvizjes së automjeteve.
- Pastrimi i rrjetit të drenazhimit të ujrave teknologjike dhe ujrave të shiut përgjatë perimetrit nën administrimin e Shoqërisë ku zhvillohet aktiviteti.
- Vëzhgimi dhe kolaudimi i vazhdueshëm i të gjithë makinerive të transportit.
- Monitorimi periodik i parametrave mjedisor dhe regjistrimi i të dhënave në regjistrin e shoqërisë.
- Sigurimi i të gjithë pajisjeve të nevojshme për riparimin, pastrimin dhe ndërhyrje në rast emergjencash.
- Trajnimi periodik i punonjësve dhe njohja me planin e ndihmës së shpejtë dhe planin e përballimit të emergjencave të ndryshme.

11.11 Masat Nderhyrese

- Riparimi i menjehershëm i difekteve dhe avarive teknologjike
- Mobilizimi i menjehershëm i stafit dhe mjeteve të fikjes së zjarrit.
- Kolaudimi dhe shërbimi i pajisjeve/makinerive nga ekspertë të licensuar, çdo fillim viti.
- Kapja, asgjësimi i menjehershëm në rastet e derdhjeve të lubrifikantëve dhe pastrimi i menjehershëm i ambientit të punës me detërgjente të posaçëm, që mund të gjenerohen nga veprimtaria dhe automjetet që kryejnë këtë shërbim.

- Zëvendësimi i menjëhershëm të pjesëve të pajisjeve/ makinerive dhe mjeteve të punës, në rastet e avarive të mundshme.
- Rigjenerimi i ambientit të dëmtuar.
- Riparimi i menjëhershëm i teknologjisë dhe automjeteve, në raste avarie të mundshme apo dëmtim të instalimeve.
- Në rastet e avarive të ndryshme do të njoftohet i gjithë stafi i punonjësve dhe klientët e gjendur aty, me qëllim sigurimin e jetës së tyre dhe ndërhyrjen për sigurimin e automjeteve dhe pajisjeve kryesore.
- Njoftimi i organeve kompetente, për rastet e mundshme.
- Pajisja e zones së aktivitetit me sinjalistikën e duhur dhe shenjat dalluese në rastet e rrezikut të mundshëm, për operimin normal të punës në objekt.
- Njoftimi i menjëhershëm i automjeteve dhe njësive të specializuara në rast emergjencash (zjarrfikëse, autoambulanca, etj).
- Rrethimi i perimetrit të territorit në shfrytëzim.
- Teritori mbahet pastër por dhe në rast se do të ketë ndotje të mjedisit ose dëmtim të tij do të marrë masa për rehabilitimin e tij si në gjendjen e mëparshme.

11.12 Masa lehtësuese për funksionimin eficient dhe të sigurtë të punës në aktivitetin e transferimit të mbetjeve:

- Të mirëmbahen mjediset e gjelbëruar në mënyrë të përhershme dhe të mbillen edhe bimë dekorative autoktone në kushte artificiale për të rritur koeficientin e gjelbërimit.
- Të shmanget në maksimum përdorimi i mjeteve të transportit kur nuk është e nevojshme dhe të reduktohen zhurmat në orët e vona.
- Të vendosen tabela paralajmëruese për rreziqet për kalimtarët dhe punonjësit.
- Të vendosen kontener për mbajtjen pastër të ambjentëve nga mbetjet urbane për numrin e punonjësve.
- Investitori të respektojë detyrimet e vendosura në Lejen Mjedisore që do të miratohet nga AKM.
- Subjekti të jetë në dijeni dhe të azhurnohet për kuadrin ligjor për mjedisin dhe ndryshimeve të tij.
- Është detyrë e zhvilluesve të aktivitetit të integrojnë elementët e domosdoshëm të propozuar për parandalimin, minimizimin dhe eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, shëndet dhe aspektin social.

- Është detyrë e Njesise Vendore gjithashtu të zbatojë rigorozisht detyrimet e përcaktuara për të garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit.
- Përcaktimi i vend---parkimit të automjeteve si dhe pajisja e vend parkimeve me sinjalistikën përkatëse.
- Do të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyre periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikanteve dhe hidrokarbureve në mjedis, emëtimin e gazeve dhe zhurmave të tepërta të shkaktuara nga avari të mundshme teknike të mjeteve.
- Veglat/Pajisjet/Makinerite e punës që shërbejnë për procese të ndryshme do të zëvendësohen me të reja, sipas jetëgjatësisë së tyre dhe efikasitetit që kanë në kryerjen e operacioneve të transferimit të mbetjeve
- Ambienti i zyrave dhe pajisjet/mjetet në zonën e shfrytëzuar do të lyhet periodikisht me bojë higjienike dhe antikorrozive, me qëllim plotësimin e kushteve Higjieno---Sanitare.
- Do të bëhet menaxhimi i mbetjeve të ngurta, të cilat do të jenë; lëndë të ambalazheve, letra---kartona, si dhe lëndë organike të prodhuara nga punonjësit, ku këto mbetje do të transportohen rregullisht në vendin e caktuar nga Njesia Vendore, ku firma do të marrë masa për menaxhimin e këtyre mbetjeve të ngurta, do të vendosen në kosha selective sipas rrymave specifike të mbetjeve.
- Do të bëhet pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujrave të shiut në këtë objekt ose e mjedisit përreth drejt mjediseve të gjetëruara. Mjedis i gjëlëruar përreth do të jetë nën kujdesin e personelit që do të punësohet vetëm për punimet agro---mjedisore të nevojshme.
- Aktiviteti disponon infrastrukturën e nevojshme, me distancat e përcaktuara për rrugë kalim të punonjësve, automjeteve, zjarrëfiksive, etj.
- Eshtë ndertuar sistemi i drenazhimit të ujrave teknologjike dhe lëvizjes së ujërave të shiut.
- Do të bëhet trajnimi periodik i punonjësve mbi kushtet e sigurimit teknik gjatë operimit të punës, si dhe të kualifikohen stafi përgjegjës për operimin e punës në instalimin për ruajtjen/magazininin transferimin e mbetjeve.

12. PROGRAMI MONITORIMIT

12.1 Qëllimet e monitorimit mjedisor

Monitorimi për parametrin që na intereson bëhet nëpërmjet matjeve të përsëritura, që merren me një frekuencë të mjaftueshme, për të bërë të mundur vlerësimin e gjendjes së mjedisit dhe ndryshimeve të tij në kohë.

Qëllimi i monitorimit mjedisor është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

12.2 Objektivat e Monitorimit:

- Të krahasojë cilësinë dhe gjendjen e mjedisit para fillimit të aktivitetit me atë gjatë funksionimit të tij.
- Të monitorojë emetimet (nëse ka) në të gjitha fazat e funksionimit të aktivitetit në përputhje me normat dhe standardet ligjore të Shqipërisë dhe BE.
- Të përcaktojë nëse ndryshimet e mundshme mjedisore janë si rezultat i zhvillimeve të aktiviteteve që kryhen në rajonin ku zhvillohet aktiviteti dhe nëse ka lidhje dhe impakte kumulative me aktivitetin e propozuar.
- Për të përcaktuar efektivitetin e masave përmirësuese të zbatuara nga aktorët zhvillues të aktivitetit në rajon.
- Për të përcaktuar impaktet afatgjatë (nëse ka).
- Për të përcaktuar zgjatjen e kthimit në normalitet të cilësisë së mjedisit në rajon, në rastet kur vlerësohet se ka ndikime dhe impakte në të.
- Të krijojë një arkivë (regjistër) të cilësisë së mjedisit, një bazë të dhënash që do të mund të përdoret në të ardhmen.
- Për të garantuar përshtatshmërinë e një objekti mjedisor për tu përdorur për qëllim të caktuar.

12.3 Plani i monitorimit

Me qenë se kemi të bëjmë me aktivitetet në Zona Urbane nevojitet një monitorim i vazhdueshëm, jo vetëm në sheshin e aktivitetit por dhe në një zonë mbi 50 m për rreth sheshit ku do të zhvillohet aktiviteti.

Plani i monitorimit do të konsistojë në:

- Monitorimin e pluhurave gjatë procesit të shkarkimit të cimentos në kamiona të cilët duhet të transportohen.
- Monitorimi i ndikimit të gazeve që krijojnë mjetet me motor me djegie të brendshme.
- Për këtë qëllim mjetet që do të përdoren nga ky subjekt do të jenë të paisura me

dokumentacionin dhe në përputhje me standartet e kontrollit të mjeteve nga entet të ngarkuara me ligj.

- Monitorim i nivelit të zhurmave.
- Monitorimin e ndotjes nga mbeturinat e ngurta. Subjekti mjeton mbetje të ngjashme me ato urbane.
- Monitorimi i parametrave fizike dhe dinamike të shpërndarjes së emetimeve të gazeve dhe marrja e masave përkatëse të parashikuara në projekt, për parandalimin e tij.
- Monitorimi i shkarkimit të ujërave të ndotura në sipërfaqen e aktivitetit

Tabela. Plani i detajuar i monitorimit mjedisor:

Nr	Cfare parametri mjedisor do monitorohet?	Ku do te monitorohet parametri?	Si do te monitorohet parametri? Cili eshte lloji i pajisjes qe do te perdoret per monitorim?	Kur dhe ne cfare frekuence do te monitorohet parametri?	Kostot e monitorimit	Pergjegjesi a
1.	Zhurmat dhe dridhjet (nga zhvillimi i aktivitetit)	Shtepia me afert me (në afersi të shtepisë)	Matja e zhurmave me matës të posaçshëm	Njëherë në tre muaj dhe vecanerisht gjatë ditëve me zhurmë të shtuar (Përfshirë në kostot e funksionimit	EUROTECH CEMENT Sh.pk
2	Pluhurat	Tek shtepia me e afert dhe në periferi të subjektit	Vezhgime në terren dhe pajisje për matjen e pluhurit total	Njëherë në tre muaj	Përfshirë në kostot e funksionimit	EUROTECH CEMENT Sh.pk
3	Cilesia e ujrave	Sistemi i grumbullimit të ujrave sipërfaqësor	Matja e turbullisë, pH, COD, pranishmësi të vajrave dhe grasave	Një herë në tre muaj	Përfshirë në kostot e aktivitetit gjatë funksionimit	EUROTECH CEMENT Sh.pk

4	Mbetje te ngurta te ngjashme me ate urbane dhe metodat e depozitimit	Ne kompani	Vezhgim ne terren	Cdo muaj	Pa kosto	EUROTECH CEMENT Sh.pk
5	Shendeti dhe siguria ne pune dhe masat e marra	Vendet e punes	Mbajtja e uniformave dhe mjeteve mbrojtese nga punonjesit dhe vizitoret, vendosja e shenave dhe sinjalistikes paralajmerues	Perdite nga Personeli i projektit. Matje te parametrave te ndotjes (zhurme, pluhur dhe gaze)	Perfshire ne koston e funksionimin	EUROTECH CEMENT Sh.pk

12.4 Plani i monitorimit te ndikimit ne mjedis.

Do te kryhet monitorimi i pluhurave, i zhurmës cilesise se ujrave megjithëse ne kemi thënë më lart që janë minimale.

Pra monitorimi do të konsistojë në matjen e parashikuar të indikatorëve mjedisor.

- Ne Subjekt respektohen standardet e normivat per nivelin e zhurmave te lejuar ditën, per vete llojin e aktivitetit qe kjo zhurme mund te krijohet nga makinat qe vijne per **Shkarkim – Ngarkim** dhe ne raste te rralla, vetem gjate ndezjes se gjeneratorit.
- Brenda teritorit relativisht mund te kete zhurme qe mund te ndikojne vetem ne shendetin e punonjesve, por jo ne ambjentin perreth per aktivitetet e tjera apo per banoret perreth.
- Ambjenti ku ushtrohet aktiviteti eshte i sheshte dhe i projektuar mire, nuk ka rritje te nivelit te zhurmave dhe nuk ndikon ne shendetin e punonjesve.
- Do te behet menaxhim me i mire i instalimeve dhe paisjeve per te mos pasur ndotje akustike dhe ndotje termike jashte normave te lejuara.
- Zhurma eshte nje tingull i padeshiruar, dhe sidomos gjate punes, por qe nuk i kemi kaluar ato te normave te lejuara per punen ditën, deri tani nuk kemi pasur ankese nga individe apo subjekte prane aktivitetit tone qe ti kemi shqetesuar per zhurme, megjithate jemi te hapur per te pritur çdo ankese te ketij lloji apo tjetër.

Të dhënat që do të mblidhen do të vihen në dispozicion të organeve shtetërore dhe të interesuarve të tjerë, gjithashtu këto të dhëna do të analizohen me qëllim përmirësimin e performances mjedisore të veprimtarisë dhe bërjen e korigjimeve të nevojshme.

Në monitorimin e sipërfaqeve të mbjella të pemëve dhe bimëve të mbjella, ecurinë normale të mbirjes dhe zhvillimit të tyre.

Në rastet kur vërehet se ka dëmtime merren masa për zevëndësimin me fidanë të rinj.

Monitorimi i çdo sipërfaqe të mbjelle do të vazhdoje për një periudhe 4 vjecare kohë gjatë së cilës bimët kanë marrë një zhvillim të konsiderushëm dhe nuk kanë nevojë për shërbim.

Planet e sigurisë dhe të menaxhimit të katastrofave hipotetike

- Plani i evakuimit të njerëzve në raste alarmi (emergjence),
- Procedurat e sigurimit në punë apo rregullat e sigurimit teknik,
- Procedurat e mjekimit dhe të ndihmës së shpejtë në raste aksidentesh në punë,
- Emrat e personave të kontaktit dhe numrat e tyre të telefonit,
- Procedurat e nënshtrimit apo fikjes së zjarrit,
- Plani i sigurisë

Shoqëria "EUROTECH CEMENT" Sh.p.k ka realizuar nje program te monitorimit nga specialiste qe do te marrin ne konsiderate mundesine per te realizuar nje monitorim realist te elementeve me ndikim ne mjedis.

Ne aktivitet duhet te jene ne gjendje gadishmerie prozhektoret dhe mjete te fuqishme ndricimi,mjetet e fikjes se zjarrit,uniformat anti-zjarr per personelin,i cili duhet te kete bere trajnimin e nevojshem per te tilla raste per te vepruar me shpejtesi dhe korrektesi.

Per sa me siper eshte e mundur qe te perzgjidhen per tu monituruarnga vete investitori ata elemente qe realisht mund te identifikohen, maten, regjistrohen dhe pastaj komunikohen ne Instancat Shteterore.

13. INFORMACIONIN PËR LEJET, AUTORIZIMET DHE LIÇENSAT E NEVOJSHME PËR PROJEKTIN, NË PËRPUTHJE ME PËRCAKTIMET E BËRA NË LEGJISLACIONIN NË FUQI, SI DHE INSTITUCIONET KOMPETENTE PËR LEJIMIN / AUTORIZIMIN/ LIÇENSIMIN E PROJEKTIT.

Shoqeria "EUROTECH CEMENT" Sh.p.k. me administrator z. **Mihail Kirilov Lazarov**, eshte i rregjistruar ne QKR me date 18.11.1997, dhe eshte pajisur me çertifikaten e rregjistrimit si person juridik, me numer **NIPT J 7231801 F**, si dhe ka dokumentacionin e kontratave qe ka lidhur per furnizimin me uje dhe energji eletrike.ku midis veprimtarive te tjera ka dhe **Magazinimi,ngarkimi ose shkarkimi ne mase te madhe i çimentos ose i klinkerit te çimentos perpara transportimit te tyre ne mase te madhe.** Subjekti do ndjek te gjitha procedurat ligjore per tu pajisur me lejet perkatese per funksionimin konform te gjitha rregullave te ketij projekti.

Nisur nga sa u paraqit me lart dhe ne dokumentacionin perkates shoqerues, perfundimisht mund te themi se projekti i Subjektit "EUROTECH CEMENT" Sh.p.k. per piken ID 3.1.d Magazinimi, ngarkimi ose shkarkimi ne mase te madhe i çimentos ose i klinkerit te çimentos perpara transportimit te tyre ne mase te madhe ne Lagja 14, Shkozet, Durrës me administrator z.Mihail Kirilov Lazarov nuk do te sjelle pasoja negative per mjedisin e zones.

Si perfundim mund te themi se projekti qe do te ndertohej konsiderohet i pershtatshem dhe i pranueshem ne zonen e zgjedhur nga investitori, pa krijuar probleme mjedisore per zonen perreth.

Hartoi materialin
STUDIO MJEDISORE
"DEA PROJEKT" Sh.p.k.
Eksperti i Vlersimit e Auditimit Mjedisor

ARJAN BALA

Çertifikuar nga Ministria e Mjedisit
Nr. 11594 Prot, Nr. identifikus 197, date 10.12.2014



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 11594 Prot.

Tiranë, më 10.12 2014

Nr. identifikues 197

ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 17.02.2011 Për një ndryshim në Vendimin Nr. 1124, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kriterëve për pajisjen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

Z. ARJAN BALA

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI


Lefter KOKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E FINANÇAVE DHE EKONOMISË
 QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

LICENCË

LN-4030-11-2017	NUIS/NIPT: L72115007S	Emërtimi përshkues i veprimtarisë
DE.A PROJEKT		Veprimtarisë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis (Auditim mjedisor dhe Vlerësimi i ndikimit në mjedis)
Adresa Tirane TIRANE Tirane Adresa: Njesia Administrative nr.7, Rruga e "Kavajes", zona kadastrale 8250, nr pasurie 1/992+3-N4		
Kodi III.2.A	Kodi tjetër	
Data e lëshimiti 2017-11-02	Afati i vlefshmërisë Pa afat	Kufizime specifike
Kategoria		Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi
Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis		Dejtime specifike
Nenkatëgoria		Licenca ushtrohet sipas dejtimeve në legjislacionin në fuqi
Veprimtarisë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis		Vendi i kryerjes së veprimtarisë
Veprimtari specifike		Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
Ndikim në mjedis, Auditim mjedisor		Nenshkrimi i portretit _____
Specialiteti		



Vuozur elektronikisht nga: Ombra
 Komisionare e Biznesit
 Data: 2020/05/21 14:54:57 +02:00
 L72115007S02000211+3+4223400

Shënim : Ky dokument është generuar dhe vuozur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra Kombëtare e Biznesit)